

## **Ftesë për pjesëmarrje në Konferencën Shkencore: “Përjetësimi i heronjve dhe dëshmorëve kombëtar për çështjen e Kosovës (1980-1999)”.**

I/e nderuar,

Kemi kënaqësinë t'ju ftojme të merrni pjesë në Konferencën Shkencore: **“Përjetësimi i heronjve dhe dëshmorëve kombëtar për çështjen e Kosovës (1980-1999)”**, e cila organizohet nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në bashkëpunim me Universitetin e Tetovës - Fakultetin Filozofik. Konferenca do të mbahet më 4 dhe 5 qershor 2026 në Prishtinë.

### **Tezat e konferencës:**

- Heroizmi dhe Lëvizja kombëtare për çështjen e Kosovës (1980–1999): Format e rezistencës politike, shoqërore dhe të armatosura në kontekstin e mohimit të drejtave kombëtare dhe represionit shtetëror serbo-Jugosllav.
- Heronjtë dhe Dëshmorët si simbol i identitetit kombëtar.
- Heronjtë dhe dëshmorët e kombit për çështjen e Kosovës 1980-1997.
- Kontributi i rinisë dhe studentëve në lëvizjen kombëtare dhe sakrificën sublime.
- Kontributi i grave dhe vajzave në lëvizjen kombëtare dhe sakrificën sublime.
- Kontributi i mërgatës dhe përjetësimi i heronjve e dëshmorëve.
- Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe përjetësimi i heronjve e dëshmorëve.
- Betejat dhe aktet luftarake të lavdishme të heronjve dhe dëshmorëve të UÇK-së.
- Heronjtë dhe dëshmorët ndërkombëtar të UÇK-së.
- Narrativat historike për heronjtë dhe dëshmorët kombëtar për çështjen e Kosovës: Qasjet historiografike, dokumentimi dhe interpretimi i figurave të rezistencës.
- Komplekset memoriale, muzetë, shtatoret dhe toponimia për përjetësimin e heronjve dhe dëshmorëve kombëtar për Kosovën.
- Krijimtaria letrare, artistike dhe mediatike për përjetësimin e heronjve dhe dëshmorëve.
- Dokumentimi arkivor dhe dëshmitë gojore për përjetësimin e heronjve dhe dëshmorëve.

### **Afatet për dorëzimin e abstrakteve dhe kumtesave të plota:**

- Afati për dorëzimin e abstrakteve: 31 mars 2026, në adresën e emailit: [instituti.historis@rks-gov.net](mailto:instituti.historis@rks-gov.net)
- Njoftimi për pranimin e punimeve: 10 prill 2026.
- Afati për dorëzimin e punimeve të plota më 4 qershor 2026, me rastin e prezantimit të kumtesës në Konferencë.

Kumtesat dhe rezultatet e kërkimeve shkencore të pjesëmarrësve në Konferencë do të botohen në përmbledhje të veçantë.

Për informacion shtesë ju lutemi të na kontaktoni në adresën e emailit:

[instituti.historis@rks-gov.net](mailto:instituti.historis@rks-gov.net)

- **Këshilli Organizativ e mban të drejtën të kërkojë ripërpunimin e temës së kumtesës së propozuar.**

**Me respekt, Teuta SHALA-PELI**

**Drejtoreshë e Institutit të Historisë “Ali Hadri”.**